



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 02.06.2023

Nr: 173

Ora: 10:25

VENDIM

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 92, DATË 27.05.2023 TË DEPOZITUAR
NGA "PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.06.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti Zgjedhor "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet"

OBJEKT:

- Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së, për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve të Zonës Zgjedhore, bashkia Librazhd.
- Ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës Zgjedhore, bashkia Librazhd për këshillat bashkiak.



BAZË LIGJORE: Nenet 123/1 dhe 124, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN SE:

Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore objekt i këtij procedimi, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 92 regj., datë 27.05.2023.

Pas hedhjes së shortit, u zgjodh relator për shqyrtimin e çështjes z. Elvis Çefa. Në seancën paraprake të datës 30.05.2023, ora 14:55, KAS vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim në datën 02.06.2023, ora 10:30.

Gjatë seancës së shqyrtimit të datës 02.06.2023 në KAS, përfaqësuesi i subjektit ankues, z. Shkëlqim Sulo, me anë të shkresës nr. 5732 prot., datë 01.06.2023, deklaroi se heq dorë nga kërkesa e tij ankimore.

Në këto kushte, duke qenë se ankuesi ka hequr dorë tërësisht nga ankimi në këtë fazë të procedimit, në kuptim të nenit 142 të Kodit Zgjedhor, atëherë KAS duhet të vendosë pushimin e çështjes në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 92, datë 27.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot në datë 02.06.2023

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**